



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

**AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

**shpall**

**K O N K U R S**

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik 2015 - 2016**

Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Fakulteti i Sigurisë Publike, në vitin e parë të studimeve, për vitin akademik **2015/2016** do të regjistrojë studentë nga Institucionet e Sigurisë Publike, sipas kuotës së përcaktuar në drejtimet e programit të studimit bachelor në sigurinë publike, si vijon:

<b>Drejtimi</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Numri i studenteve</b>
Policor	Inspektorati Policor i Kosovës	<b>5</b>
Doganor	Dogana e Kosovës	<b>1</b>
Menaxhimi Emergjent	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	<b>8</b>
Korrektues dhe Sprovues	Shërbimi Korrektues i Kosovës Shërbimi Sprovues i Kosovës	<b>7</b> <b>5</b>

**KUSHTET E KONKURSIT**

Në konkurs mund të paraqiten kandidatë të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të vërtetuar me diplomë;
2. Të jenë të punësuar në Institucionet e Sigurisë Publike, respektivisht në:
  - 2.1 Policinë e Kosovës si zyrtar policor;
  - 2.2 Doganën e Kosovës si zyrtar doganor;
  - 2.3 Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës;
  - 2.4 Shërbimin Korrektues të Kosovës si zyrtar korrektues;
  - 2.5 Shërbimin Sprovues të Kosovës, dhe
  - 2.6 Inspektoratin Policor të Kosovës.

3. Të kenë se paku tre (3) vite përvojë pune në agjencitë përkatëse të sigurisë publike;

Kandidatët mund të konkurrojnë vetëm në drejtimin e studimit sipas institucionit punëdhënës.

Me rastin e konkurrimit, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- Formularin e aplikimit (mund ta shkarkoni në ueb faqen e Akademisë [aksp.rks-gov.net](http://aksp.rks-gov.net))
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e kartelës identifikuese të punës;
- Dëftesat origjinale të të gjitha klasave të shkollës së mesme ose kopjet e noterizuara sipas origjinalit.
- Diplomën origjinale të shkollës së mesme ose kopjen e noterizuar sipas origjinalit.
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
- Kontratën e punës e cila dëshmon marrëdhënien e punës në ndonjërin nga agjencitë e sigurisë publike (kopje);
- Një vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon se i njëjti aktualisht është në marrëdhënie pune (data e lëshimit pas shpalljes së këtij konkursit).

Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, në **Objektin e ri Fakulteti i Sigurisë Publike Nr. i Zyres 111**.

Kandidatet që paraqiten në konkurs rekomandohet të kenë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në përfundim të studimeve apo çregjistrim nga fakulteti.

#### MENYRA E STUDIMIT

Për studentet që vijojnë studimet në programin bachelor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, mënyra e studimit do të jetë si në vijim:

- Pjesa teorike (ligjëratat) vijohet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike gjatë tri (3) ditëve të punës brenda javës, në ditët e hënë e martë dhe e mërkurë.
- Pjesa praktike (Internshipi) vijohet pas përfundimit të ligjëratave, më së largu deri më 30 shtator të çdo viti përkatës akademik në vendet e caktuara të punës në institucionet përkatëse konform plan programit mësimor.

***Studimet bachelor për pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike ofrohen falas dhe pa shkëputje nga puna.***

#### AFATET E KONKURSIT

**Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 19.08.2015 deri më 25.08.2015 në ora 16:00.**

**Provimi pranues do të mbahet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, më 28.08.2015 duke filluar prej orës 10.00.**

Lidhur me provimin pranues kandidatet mund të referohen në Manualin për Përgatitjen e Provimit Pranues, të cilin mund ta shkarkoni në ueb faqen e Akademisë [aksp.rks-gov.net](http://aksp.rks-gov.net)

Kandidatët të cilët i nënshtrohen provimit pranues duhet të kenë me vete një dokument të identifikimit.

Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet me datën **01.09.2015**, në ueb faqen e Akademisë [aksp.rks-gov.net](http://aksp.rks-gov.net)

Kandidatët të cilët nuk pranohen në vitin e parë të studimeve mund të paraqesin ankesë pran Komisionit të Ankesave në AKSP, nga **02.09.2015** deri më **04.09.2015**.

***“Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të studimit për të gjithë pjesëtarët e agjencive të sigurisë publike dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë femërore dhe mashkullore përfshirë të gjitha komunitetet në Kosovë”.***

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Shërbimeve Studentore në numrin e tel:**028 590 070 ext 323** ose **326**, çdo ditë prej orës **08:00 – 16:00**.